

# FAKTORI PËR ARMIQËSINË E VËLLAUT

# STRATEGJIA

Ebu AJAN

Falenderimi i takon vetëm Allahut, vetëm Atë falenderojmë! I kërkojmë ndihmë, falje dhe mbrojtje nga të këqijat e veteve tona e nga të këqijat e punëve tona. Atë që e udhëzon Allahu nuk ka kush e humb dhe atë që Ai e humb nuk ka kush e udhëzon! Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër veç Allahut dhe Muhamedi është rob dhe i dërguar i Tij.



**"O ju që keni besuar! Kini frikë Allahun ashtu siç duhet pasur frikë Ai dhe mos vdisni ndryshe veçse duke qënë muslimanë".**

**"Keni frikë All-llahun nga fitneja (sprova) e cila nuk i godet vetëm ata që kanë bërë padrejtësi".**

Në rreshtat në vijim do të mundohem t'i them disa fjalë, thënie, këshilla, fillimisht duke e këshilluar vetveten pastaj dhe të tjerët. Askush nga ne nuk mund dhe nuk ka të drejtë të pretendon imunitetin nga gabimet.

Pejgamberi sal'allahu alejhi ue selem, thotë: **Çdo bir i Ademit është gabimtar, por më i miri i gabimtarëve është ai që pendohet!**

Nuk është gabim dhe turp që të pendohesh, por gabim dhe turp është kur mundohesh ta arsyetosh vetveten nga gabimi, ngase kjo të pamundëson inspektimin dhe zbulimin e të metave tua, dhe aq më shumë evitimin e tyre.

Lus Allahun e Lartësuar që këto fjalë të më bëjnë dobi mua dhe juve.

Në vijim do të përmend disa fjalë të arta nga kolosi, dijetari i madh Islam, shejhul Islam Ibn Tejmije, fjalë dhe këshilla të cilat përputhen me tematikën të cilën me lejen e Allahut do ta trajtojmë më poshtë.

Thotë: Do të them vetem kuptimin e atyre fjalëve që më lanë mbresa të medha, ngase nuk më kujtohet citati) "Të këshillosh është sikur kur marim abdest, dora e djathtë e fërkon të majtën dhe anasjelltas, ndodh që ndonjëherë njëra dorë të fërkon më shumë tjetrën, kjo ngase është njollosur, me qëllim që ta pastroj nga ajo njollë, papastërti, dhe jo që ta lëndojë, edhe pse mund që të ndjen dhimbje.

Kështu është edhe me këshillën, nëse të këshilloj dije se me këtë synoj të njejtën gjë, pra pastrimin tënd nga veset dhe dukuritë e këqija të cilat i posedon, ose largimi dhe pendimi

nga gabimet të cilat ka mundësi që të kishe rënë duke mos qenë i vetëdijshëm për te, kjo mund të të iriton, apo të të zemëron ndoshta, por dije se ky nuk ka qenë qellimi im. Kështu ngase të kam vella, dhe atë që dua tek vetja ime, e dëshiroj edhe tek ti, dhe atë që urrej tek vetja ime e urrej edhe tek ti.

Lus Allahun e Lartësuar që të mos keqkuptohemi. Të mos përsëritet e njejta gjë, duke adresuar akuza për lëshime drejtshkrimore, sikur që ka ndodhur në shkrimet e mëhershme, dhe kjo të kujton thënien e njohur, për tu mbrojtur nevojitet sulmi, edhe atë me çdo kusht, sa që edhe me kësi lloj sulmesh të cilat janë banale...

Para se të kalojmë në temë, dëshirojë të theksoj, se gjatë kohë kam menduar se a t'i shkruaj këto fjalë ne vijim apo jo, dhe këtë analizë e kam bërë për hir të së mirës së davetit, kjo ngase situata është shumë e ndijshme, e brishtë dhe tensionuese, dhe shumë shpejt mund që të eskalojë në përmasa të mëdha, mirëpo duke marrë parasyh faktorin kohë, prolongimin e kësaj sate, duke mos shfaqur në skene asnjë simptom, shenjë, optimizëm duke aluduar në atë se gjrat po kthehen në vend të vet, nga njëra anë dhe pasojat të cilat janë shkaktuar në fushën e davetit, mjegullimet, paqartësitë, kështu duke bërë gjendjen edhe më alarmante, nga ana tjetër, nuk mbetet asnjë hapësirë që të mos ngritet zëri ndaj kësaj dukurie...

Faktori kohë në këtë rrugë, në realizimin e objektivave të davetit dhe misionit Islam në përgjithësi, është e predispozuar të jetë e gjatë, por sukcesi është i sigurtë..

### **Andaj kalojmë në temë...**

Rrugë e vështirë, e gjatë, metodologji që kërkon durim, qëndrim, dhe stabilitet në parime. Është rrugë që kërkon mund, ambicje, sakrificë, përpjekje të vazhdueshme, ballafaqim me sfida , ndërsa të gjitha këto duhet të stolisen me durim permanent..

Është rrugë e burrave, vetëm ata mund t'i bëjnë ballë sfidave dhe peripecive që dalin nga kjo rrugë.

Faktori kohë në këtë rrugë, në realizimin e objektivave të davetit dhe misionit Islam në përgjithësi, është e predispozuar të jetë e gjatë, por sukcesi është i sigurtë..

**Dhe se kjo është rruga Ime e drejtë, prandaj pasojeni atë dhe mos pasoni rrugë të tjera që ju shmangin nga rruga e Tij.**

Pejgamberi, salallahu alejhi ue selam, tha: "Kjo është rruga e Zotit dhe Ai ju udhëzoi të ecni sipas saj (për vijën e drejtë dhe të gjatë). Kurse këto janë rrugët e shejtanit (për vijat e shkurtra) dhe në secilën prej tyre ka nga një shejtan që i thërret ata që janë në rrugë të drejtë duke u thënë: "Ku po shkoni! Kjo është rrugë e gjatë shumë. Keni për t'u munduar dhe keni për t'u lodhur shumë. Hajdeni këtej, tek këto rrugët e shkurtra". Tha profeti, salallahu alejhi ue selam: "Mos u besoni, se këta që ju thërrasin në këtë mënyrë janë shejtana. Ecni sikur e keni marrë rrugën e drejtë, sepse ajo rrugë ju çon në xhennetin e Allahut".

Allahu I Lartësuar thotë: "...Të jeni të durueshëm se All-llahu është me të durueshmit." (Enfal:46)

I Dërguari i Allahu ka thënë: **“Dijeni se fitorja vjen me sabër, e shpëtimi vjen pas brengës dhe pas vështërsive vjen lehtësimit.”** (Imam Ahmedi,1/307)

Nëse nuk bëjmë durim gjatë vështirësive, por kërkojmë lehtësime të cilat nuk janë të justifikuara në Islam, atëherë a thua vallë kur do të shijojme lehtësimet të cilat i ka permendur Pejgamberi i Allahut?!

Preokupimi i pasuesve të saj është shpjegimi i teuhidit dhe ndalja nga shirku, pastrimi i fesë nga elementet destruktive prej bidateve, thënieve të kota, izolimi dhe luftimi i tyre.

Shumë nga pasuesit e këtij menhexhi, duke ecur rrugës së gjatë, me të arritur tek pushteti, u zhveshën nga personaliteti Islam, u larguan nga kjo rrugë, jo vetëm kaq, por edhe e sulmuan atë dhe pasuesit e saj, u përngjasuan me ithtarët e bidateve...

Jo rrallë herë ndodh që veprimet ti emërtojmë si dështime ose suksese, kjo varet nga epilogu i këtyre veprimeve...Vështirësia është kur duhet tu bësh ballë sfidave që dalin nga kjo rrugë, dhe jo duke abstenuar nga ata, për të gjurmuar pas lehtësimeve, të cilat janë jashtë konceptit të menhexhit të drejtë...Nga çdo sprovë ballafaquese me dështimin ose suksesin na duhet të nxjerrim mësim.

Mosuksesi në ndonjë synim nuk duhet që të jetë shkak që ta ndryshojmë menhexhin, por e udhës do të ishte që të hulmumtohen shkaqet të cilat janë përgjegjës kryesorë për këtë apo atë mosukses dhe që më pastaj në të ardhmen të evitohen.

Neve na takon që ta kumtojmë dhe përcjellim të vërtetën ndërsa suksesi është në dorën e Allahut.

Në momentin kur ndokush nga pasuesit e këtij menhexhi "lodhet", e kaplon plogështia, i duket rrugë e gjatë, ngase natyra e njeriut është e tillë që kërkon rezultate të shpejta, pra është i ngutshëm, i tilli nuk heziton ta "shkurton" këtë rrugë, në emër të davetit duke u futur nëpër rrugica, qorrsockake, për të cilët na paralajmeroi Pejgamberi i Allahut, dhe ajo që është më e keqja këtë devijim e quan "hikmet", "largpamësi": **“Dhe mos u bëni si ata të cilët u ndanë dhe u përçanë pasi që iu bë e qartë, e këta kanë dënim të madh”.**

...thyen kriteriumet e tolerancës, duke pranuar demokracinë dhe rregullat e saja (e dogji kartën e Islamit), u shtrënguan dorën grave të huaja, u ngriten para himnës kombetare, ndokujt i pëlqeu tuna, dhe e gjithë kjo është bërë në emër të "davetit"....

Shumë nga pasuesit e këtij menhexhi, duke ecur rrugës së gjatë, me të arritur tek pushteti, u zhveshën nga personaliteti Islam, u larguan nga kjo rrugë, jo vetëm kaq, por edhe e sulmuan atë dhe pasuesit e saj, u përngjasuan me ithtarët e bidateve, thyen kriteriumet e tolerancës, duke pranuar demokracinë dhe rregullat e saja (e dogji kartën e Islamit), u shtrënguan dorën grave të huaja, u ngriten para himnës kombetare, ndokujt i pëlqeu tuna, dhe e gjithë kjo është bërë në emër të "davetit".

Zanafilla e këtyre dukurive, paraqitjeve, buron nga jostabiliteti dhe paaftësia mendore, zbehja e vendoshmërisë, qëndrueshmërisë dhe durimit. Ndërsa dështimi në të shumtën e rasteve është produkt i mendjes së paaftë.

*Ne gjithmonë shikojmë ne pasqyre që të dukemi të bukur për të tjerët. Tash shiko ne veten tënde dhe pyete vetën, a dukesh i bukur për Allahun..*

Të jesh faktor në fushën e davetit, duke mbartur në vete komponentën e suksesit, progresit, dhe më pastaj të synosh bashkimin me ithtarët e bidatit, kjo është absurd. Kjo strategji e shpikur, gjatë një perceptimi dhe studimi jo të thellë, del se është një iluzion dhe jo realitet.

Ahmed Ibn Hambelit i cili qëndroi në hak, edhe pse ishte i lënë i vetëm në këtë nga të afërmit e tij. Ti je xhemat edhe nëse je i vetëm. Ata nuk u bashkuan me ta, por i izoluan ata, sikur të ndodhte kjo, a thua vallë si do ta kishte hallin ky ummet sot?!

Sikur kolosët tanë të parë të ndershëm dhe të drejtë, nuk do të luanin rolin e njohur të tyre, duke shfaqur në skenë vlerat e mirëfillta, krenarinë dhe vendoshmërinë e tyre për të ndihmuar dhe mbrojtur këtë fe dhe menhexh, duke ngritur zërat e tyre lartë kundër ithtarëve të bidatit, grupeve të devijuara, kundër sulltanave, a thua vallë do të kurorëzohej me sukses ky veprim i tyre, siç ishte rasti i Ahmed Ibn Hambelit i cili qëndroi në hak, edhe pse ishte i lënë i vetëm në këtë nga të afërmit e tij. Ti je xhemat edhe nëse je i vetëm.

Ata nuk u bashkuan me ta, por i izoluan ata, sikur të ndodhte kjo, a thua vallë si do ta kishte hallin ky ummet sot?!

Ka thënë Pejgamebri sal-l Allahu alejhi ue selem : **“Ju kam lënë në një (rrugë) të bardhë, nata e saj është si dita e saj. Nuk humbet prej saj vetëm se ai që është i shkatërruar”** Thotë Malik ibn Enesi: “Fundi i këtij Umeti nuk ka për t’u përmirësuar përveç se nga ajo me të cilën u përmirësua pjesa e parë e tij.”

Kushdo që dëshiron të ripërtrinë fenë duke përdorur metoda të tjera në vend të asaj që e përmirësuan brezat e parë, ky veprim i tyre do të pasojë disfate.

Thotë sheikh Ibn Bazi: “Çdo bidat, devijim dhe metodologji (*minhaxh*) që kundërshton ligjin e Allahut duhet të hidhet poshtë. Të gjithë duhet të ndjekin metodologjinë (*minhaxh*) në të cilën ka qenë i Dërguari i Allahut (*sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem*), pastaj Sahabët e tij (*radij-Allahu ‘anhum*) dhe Khalifët e Udhëzuar (Kulefa’i Rashidin) që e ndoqën atë (*sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem*) dhe pastaj Imamët e Udhëzuar dhe Selefus-Salih (të Parët tanë të Mirë) që i ndoqën ata. Ata ishin të gjithë në metodologjinë e saktë dhe në rrugën e drejtë (*siratal-mustekijm*)”.

Shumë nga këta “pasues të lodhur” që proklamojnë dhe e pretendojnë këtë strategji jo të re, kane dështuar dhe vazhdojnë të dështojnë, duke mbetur në gjysmë të rrugës, por ajo që na habit më së shumti, është fakti, se si disa edhe përkrah gjithë këtyre dështimeve dhe dëshpërimeve, ua kanë lakmi, dhe për njëherë i shikon ata bëhen “largpamës”, duke ecur

pas hapave të tyre, duke gjurmuar pas rrugicave të cilat sipas tyre do të mundësonin arritje dhe realizmi sa më të shpejtë të objektivave të thirrjes Islame. Mjerim! Deshtuesit aplikojnë metodat e vjetra dhe dështimi i kalon një tjetër dështimi pasues.

Dikur lavdëroheshin ndërsa sot shahen, a thua vallë ku qendron problemi?! Faji është ndokund, për të cilën koha ka dëshmuar për dështuesit e parë, të dytë,...dhe në një të ardhme shumë të shpejtë do të dëshmon edhe për ata të cilet lakmuan pas atyre!

Dhe si rezultat kemi ndryshim të kursit të thirrjes Islame, fasadës dhe koncepteve të metodologjisë, e gjithë kjo në vete ngërthen zgjidhjen e imponuar nga jashtë. Pra, kjo të kujton një shfaqje teatrale, që e kthen umetin në spektator pasiv të dramës, e gjëja më e madhe që mund të bëjë spektatori në një shfaqje është të duartrokasë apo të shpreh pakënaqësi, sipas rrjedhës së subjektit dhe mesazhit të tij.

Sa miq janë bërë armiq, edhe pse ata që u akuzuan ishin të njejtit po ata të cilët më herët u lavdëruan nga ata të cilët i akuzuan.

Dikur lavdëroheshin ndërsa sot shahen, a thua vallë ku qendron problemi?! Faji është ndokund, për të cilën koha ka dëshmuar për dështuesit e parë, të dytë,...dhe në një të ardhme shumë të shpejtë do të dëshmon edhe për ata të cilet lakmuan pas atyre!

Koha ka dëshmuar se çdokush i cili i kundërvihet proganduesve të kësaj strategjie është akuzuar për njeri ekstrem, tekfirc, njeri pa urtësi, pa edep, pa etikë dhe kulturë Islame, ndërsa çdokush i cili i është përgjigjur dhe nënshtruar asaj strategjie, i tilli është konsideruar për njeri me edep, ose nëse ka poseduar një gjë të tillë më së paku nuk është folur për "mosedepin" e tij!

Këta armiq me të cilët synohet bashkimi, jo vetëm që janë të cekët në dituri dhe kuptim, përskaj ndjekjes se epshit, pasioneve, devijimit të qartë si dhe mosnjohjes së rregullave elementare të usuli fikhut që kane të bëjnë me analogjinë, (të cilët aplikojnë këtë mekanizëm edhe kur për një çëshjtje kemi argumente të qarta nga dy burimet kryesore), por janë edhe mbrojtës të injorancës dhe fanatizmit të tyre.

Këta armiq me të cilët synohet bashkimi, jo vetëm që janë të cekët në dituri dhe kuptim, përskaj ndjekjes se epshit, pasioneve, devijimit të qartë si dhe mosnjohjes së rregullave elementare të usuli fikhut që kane të bëjnë me analogjinë, (të cilët aplikojnë këtë mekanizëm edhe kur për një çëshjtje kemi argumente të qarta nga dy burimet kryesore), por janë edhe mbrojtës të injorancës dhe fanatizmit të tyre.

Në pyetjen që i është drejtuar shejh Albanit rahimeullah rreth bashkimit me ndonjërin nga grupet e devijuara, shprehet si në vijim:

"Pyetje: A është e mundur që këto 73 grupe, të cilat i ka përmendur profeti në hadith, të punojnë bashkë apo të bashkohen të gjithë në një?! Përgjigje: Këto grupe, në qoftë se e kanë lënë rrugën e profetit, salallahu alejhi ue selam, nuk mund të bashkohen, sepse Hakku (e verteta) me Batilin (me të kotën) nuk mund të bashkohen asnjëherë. Rrugët e tyre kundërshtojnë njëra-tjetrën, kështu që ata nuk mund të ecin bashkë...."

Kjo "strategji e re" është një proces i komplikuar, produkt i një ideje e predispozuar të jetë gabim, ideatori i të cilit quhet iluzionist, zbatuesi i saj mendjelehtë, ndërsa epilogu i tij disfatë.

Përgjegjësit kryesor për krizën mendore që është implikuar në mendjet tona, janë po ata drejtues të cilët përdorin fjalën "hikmet", për të fshehur epshin e tyre për famë dhe udhëheqësi. Në rastin e disa drejtuesve të davetit, strategjia e tyre duhet emërtuar me emrin e trishtueshëm që meriton: tradhti të metodologjisë.

Kjo ide që është proklamuar më herët dhe që proklamohet akoma edhe në ditët e sodit është kanceri i shoqërisë Islame, dhe është koha që kjo ide të demaskohet.

Si rezultat i këtij kanceri, thirrja islame sot, po kalon ditë të vështira, kudo nëpër botë, le të shpresojmë se të gjithë ne, por veçanërisht predikuesit e saj do të nxjerrin konkluzionet e duhura nga ngjarjet e turpshme dhe të dhimbshme.

Në fjalorin tonë nuk është e panjohur fjala, bashkim dhe bashkëpunim, ky nocion bashkim mbetet një aspiratë por jo realitet, dhe kjo aspiratë ka të ngjarë të mos realizohet edhe për shumë kohë po që se refuzojmë t'i themi gjërat ashtu siç janë.

**"Islami ka filluar i huaj dhe do të kthehet i huaj siç ka filluar . Tuba është për të huajt".**

Këta njerëz me të cilët pretendoni të bashkoheni kanë nevojë ta korigjojnë dhe kontrollojnë besimin dhe menhexhine tyre, besojmë në dëlirësinë e tyre, por jo edhe në diturinë e tyre. "Askush të mos e imitojë dikë në fenë e tij, në mënyrë që nëse ai beson dhe ky beson, nese ai mohon edhe ky mohon. Mirepo nëse duhet që medoemos që të merrni dikë per shembull, atëherë merrni ata që kanë vdekur, sepse i gjalli nuk ka garanci që nuk do bjerë në fitne (sprove). " Ibn Mesudi radijallahu anhu

Feja jonë është fe e bashkimit dhe jo e përçarjes, por bashkimit në një hak, ngase nuk janë dy.

Vazhdimisht ndëgjojmë se jemi të izoluar, të mbyllur, njerëzit flasin keq për ne, me një fjalë jemi të huaj, duke harruar të gjerët hadithin e Pejgamberit a.s.: **"Islami ka filluar i huaj dhe do të kthehet i huaj siç ka filluar . Tuba është për të huajt"**. (Transmeton Muslimi dhe të tjerë nga Ebu Hurejre)

Në një transmetim të hadithit thuhet: **"Tuba është për të huajt. I thanë : Kush janë të huajt o i dërguari i Allahut ? Tha: Njerëz të mirë (të devotshëm) të pakët ndër shumë njerëz të këqinj. Ata që i kundërshtojnë janë më shumë se ata që i dëgjojnë"**. (Transmeton Ahmedi dhe Ibn Mubarek , e saktësoi Albani)

Në një transmetim tjetër thotë: **"Këta janë ata që rregullojnë, kur njerëzit janë të prishur"**. (Transmeton Ebu Amr Ed-dani e saktësoi Albani)

Përgjegjësit kryesor për krizën mendore që është implikuar në mendjet tona, janë po ata drejtues të cilët përdorin fjalën "hikmet", për të fshehur epshin e tyre për famë dhe udhëheqësi.

Ndëgjojmë të thonë njerëzit se duhet të jemi më tolerant dhe se duhet t'i arsyetojmë armiqt tanë në çështjet që nuk pajtohen me ne, duke haruar që kjo ka nevojë të përkufizohet dhe të përcaktohet, kështu ngase divergjencat në mendime janë dy llojëshe, i pari divergjencia që kanë qenë evidente edhe në mesin e sahabeve si psh,. divergjencat në mes të sahabeve rreth asaj se Ibn Sajjada a është Dexhalli apo jo. Megjithë mospajtimet mes tyre e kanë arsyetuar njëri-tjetrin.

Sepse gabimi i tyre nuk arsyetohet, ngase është dalje nga besimi dhe metodologjia islame. Në rast se dikush nga ne del dhe devijon nga besimi dhe metodologjia islame nuk duhet ta arsyetojmë atë. Me fjalë tjera këshillojmë por nuk lejojmë parregullsi.

Dhe e dyta, divergjencat në bazat e fesë, nëse nuk është kështu ateëherë pse nuk i arsyetoi Ahmed ibën Hanbel mutezilët, por i kundërshtoi si luan ata?! Pse? Sepse gabimi i tyre nuk arsyetohet, ngase është dalje nga besimi dhe metodologjia islame. Në rast se dikush nga ne del dhe devijon nga besimi dhe metodologjia islame nuk duhet ta arsyetojmë atë. Me fjalë tjera këshillojmë por nuk lejojmë parregullsi.

**“Mbahuni fort të gjithë sëbashku në litarin e Allahut dhe mos u përçani!”**

**“... në litarin e Allahut...”**

Pra, në mometin kur i prish lidhjet me litarin e Allahut, automaitikisht i prish raportet edhe me pasuesit e menhexhit të drejtë.

Shpeshherë dëgjojmë të flitet për mosfunksionim të aparatit të davetit, duke e shpeshtuar këtë atak në mënyrë intensive në metodën e prezantimit të saj, duke harruar se progresi nuk mund të arrihet duke kaluar nga linjat kryesore në ato anësore, duke anashkaluar elementet bazë, pa të cilat nuk mund të jep fryt strategjia aktuale.

Nga gabimi i ithtarëve të këtij iluzioni është se ata ua sqarojnë njerëzve rregullat e njohjes së fesë, ndërsa nuk ua qartesojnë themelet e fesë, ua sqarojnë çështjet dytësore dhe jo ato parësore, dhe kjo për të arritur kulminacionin e turpit, këtë e quajnë “politikë”.

Shembulli i kësaj është sikur shembulli i atij i cili dëshiron të ndërton shtëpinë, mirëpo nuk din si, andaj për shkak të mosditurisë, ja fillon prej në kulm! Kjo, a është e logjikshme?! Në fakt ky njeri asnjëherë nuk do të mund të ndërton shtëpine e tij!

Ibadeti i shumtë, lutjet e shumta, xihadi, sexhdeja nuk i bën dobi njeriut nëse nuk është në Rrugën e drejtë.

Paqartësia e pozicionit të predikuesve të saj, shfaq në skenë shumë elemente të cilat nuk mund të jenë premisa për një të ardhme të mirë dhe të shëndoshë Islame.

Mençuria, autoriteti dhe fama, nuk posedojnë forcë që të parandalojnë dhe të frenojnë të zotin e saj nëse ai shfaq tendenca për t'i shfrytëzuar për të keq, e cila e keqe në definicionin e tyre ka botëkuptime të së “mirës”.

Mençuria, autoriteti dhe fama, nuk posedojnë forcë që të parandalojnë dhe të frenojnë të zotin e saj nëse ai shfaq tendenca për t'i shfrytëzuar për të keq, e cila e keqe në definicionin e tyre ka botëkuptime të së "mirës".

Kjo ide, kjo rrugë dhe kjo metodologji është e predispozuar që të jetë e dështuar, e cila fillimin e ka dështim ndërsa fundin dëshpërim.

Askush nuk mohon nevojën e implementimit të reformave e cila nënkupton të ripertërisht fenë tënde duke i ftuar njerëzit në gjërat e harruara, dhe jo duke shpikë dhe trilluar ide dhe strategji të reja, përsëri strategji ekzistuese të fortë dhe të qëndrueshme.

Nëse kështu e kuptojmë reformën, atëherë i bie sikur njëri të ngritet dhe të thotë: Me vite po thoni se e bardha është e bardhe ndërsa e zeza është e zezë, ç'është kjo ngurtësi?! Ç'është ky izolim? Ç'është kjo mbyllje! Kemi nevojë për reforma, zgjerim, bashkim me armiq. Të themi se e bardha është e zeze, dhe anasjelltas! APSURD.

Përcjelljet nga Irbad ibn Sarije të ketë thënë: Na këshilloi Pejgamberi, paqja e All-llahut qoftë mbi të, me një këshillë prej të cilës sytë rrjedhën lotë dhe zemrat u frikësuan. Njerëzit thanë: Sikur të ishte kjo këshillë lamtumirëse. Pra, na porosit! Tha: Iu porosis të mendoni! Jo! Por, tha Pejgamberi: Iu porosis t'i druani All-llahut dhe t'i respektoni kufinj të Tij, dhe iu porosis të dëgjoni e të respektoni, po edhe nëse iu bëhet udhëheqës një rob! Ngase kush do të jetojë pas meje do të shohë mospajtime të mëdha. Përmbajuni sunnetit (udhëzimit dhe praktikës) tim dhe sunnetit të halifëve të drejtë dhe udhëzues pas meje! Kapuni për to me dhëmalla dhe ruajuni nga gjërat e reja në Fe, ngase ato janë bidate dhe çdo bidat është shmangje nga Rruga e drejtë dhe çdo shmangje çon në zjarr të xhehennemit."

Është për tu habitur, nëse bëjmë një analizë të së kaluarës Islame, në veçanti ideatorëve të kësaj ideje, faqet e historisë janë të mbushura me përplot dështime të njëpasnjëshme, që nuk len hapësirë për hamendje, e ku më për ta transformuar këtë ide në një praktikim real. Ndoshta predikuesit modern të kësaj ideje, fajin ia hedhin propaganduesve të saj dhe jo vetë idesë, kështu duke u mbështetur në vetveten e tyre, famën e tyre, autoritetin e tyre, potencialin e tyre mendorë, dhe kjo sdomend se është proces paradoksal, destruktiv.

Kjo ide në vetvete ngërthen shpresë pa sukses, lëvizje pa progres, udhëtim pa fund, rrotë që lëvizë në një vend.

Shpeshherë dëgjojmë se daveti nuk lëviz me tempon e duhur, dhe se për këtë faji i adresohet personave të caktuar duke harruar vetveten. Flitet për të jashtmen e davetit se si ajo manifestohet dhe akceptohet nga jashtë, dhe e cila po nga të njëjtit paraqitet si e mjerë, e vobektë, jo progresive, e izoluar, në këtë kontekst duke harruar dhe anashkaluar të brendshmen e saj, e cila nuk është aspak më e bardhë se e jashtnja e saj, kështu është prej momentit kur u akuzua strategjia jonë, ngase më pare nuk ka qenë kështu, me parë kishte harmoni mes hoxhallarëve edhe përkrah divergjencave në mendime që posedonin, dhe kjo gjithsesi manifestohej dhe reflektohej tek xhemati, të cilët ishin unik dhe të bashkuar dhe kjo quhet sukses, meritat e cilës i takojnë vepruesve të saj,

...faqet e historisë janë të mbushura me përplot dështime të njëpasnjëshme, që nuk len hapësirë për hamendje, e ku më për ta transformuar këtë ide në një praktikim real....

atyre të cilët janë pa “edep”, ndërsa gjurmët që i ka lënë pas kjo “strategji e re”, le të kuptohet se ata dërgojnë nga sukcesi në mospukje, nga progresi në fundosje, të cilën do ta dëshmojmë më vonë.

Më pëlqeu një thënie nga një njëri i mençur kur tha se duhet të bëhet dallim mes politikës së Fesë dhe Fesë së politikës, e cila në fakt është edhe nga konceptet e Ehlus-sunnetit. Feja ka politikën e vet dhe politika e ka fenë e vet, dallimi mes këtyre të dyjave është evidente...prandaj të mos përzihen këto dy shprehje.

Nëse dikur kemi qenë të bashkuar dhe unik, sot jemi të përçarë dhe të acaruar, e cila është në hovin e sipër, dhe kjo nuk mund të quhet ndryshe vetëm se dështim! Kjo është njëanshmëri, dhe si e tillë nuk është e drejtë, që të jemi objektiv duhet që të marrim në konsideratë edhe të brendshmen edhe të jashtmen e saj, dhe më pastaj të jepet një gjykim real. Pra, kjo strategji në nivel lokal paraqet njëanshmëri, ndërsa në nivel të përgjithshëm skajshmëri.

Më pëlqeu një thënie nga një njëri i mençur kur tha se duhet të bëhet dallim mes politikës së Fesë dhe Fesë së politikës, e cila në fakt është edhe nga konceptet e Ehlus-sunnetit. Feja ka politikën e vet dhe politika e ka fenë e vet, dallimi mes këtyre të dyjave është evidente...prandaj të mos përzihen këto dy shprehje.

Të synosh rregullimin me të tjerët dhe gjatë këtij procesi të prishësh raportet me të afërmit, nuk më duket e udhës, në fakt kjo është ndarje, një fjalë popullore thotë “nëse nuk je i aftë për veti, nuk je as për gjeti”; e udhës do të ishte të rregulloni raportet njëherit me të afërmit tu, dhe tek pastaj të kaloni tek fqinjët..., dhe çelësi i këtij rregullimi gjendet tek konsultimi me të afërmit tu, gjithsesi duke ju referuar dy burimeve kryesore, dhe jo duke marë instruksione nga jashtë dhe më pastaj të vendosësh në bazë të tyre, kjo quhet njëanshmëri. Njëherë të sillni vendime e më pastaj të i konsultoni të tjerët, kësaj i thonë humbje kohe, apo fitim në kohë, ngase fillimisht duhet të konsultohen të gjithë e më pastaj të dilet me vendim unanim dhe jo të njëanshëm, dhe më e keqja të veprohet me atë vendim pa konsultim paraprak!!!

**"Kur thirren besimtarët për gjykim ndërmjet tyre të All-llahu dhe të i dërguari i Tij, e vetmja fjalë e tyre është të thonë: "Dëgjuam dhe respektoam!" Të tillët janë ata të shpëtuarit."**

Pandërprerë të akuzosh të afërmin, ndërsa në vazhdimësi të lavdërosh të huajin, e gjithë kjo gjoja se në emër të bashkimit, nuk mund të kuptohet ndryshe vetëm se i afërmi i tij në realitet është i huaji i tij dhe anasjelltas, dhe e gjithë kjo për të kënaqur pasionet e dikujt, i vetëdijshëm për këtë apo jo. Kjo është një realitet i hidhur e cila sdomend se dëmton davetin, të kthen mbrapa në kohë për disa vite, bën që dinamika e davetit të stagnon...dhe kjo më së shumti i konvenon armiqve të Islamitë

Lehtë është të akuzosh, por shumë vështirë është të ballafaqohesh me pasojat e saj.

Lehte është të japësh ide, mendim, por sa ajo ide është me vlerë, me vend, me peshë. E vështirë është të eksperimentosh por edhe më vështirë është të ballafaqohesh me rezultatet e saja negative. Dhe aq më keq kur futen në jetë hipotezat, eksperimentet të cilët janë treguar si të dështuara!

Të mbivlerësosh sukseset e të huajve, ndërsa të nënvlerësosh sukseset e të afërmëve tu, kësaj i thonë shitje.

**“Thirr në Rrugën e Zotit tënd me Urtësi...”**

Kjo do të thotë, thirrë me dije, “Allahu thotë”, “I Dërguari i Allahut thotë” dhe duke i vendosur gjërat në vendin që u takon, dhe jo me mendime dhe ide të gabuara, (ndryshoi filan dijetari, e lejoi ky, e bëri ai...), që të bën të mendosh vallë këta njerëz janë pauses të Pejgameberit apo mukalid?!

Të paraqitesh i mirë nga jashtë, ndërsa brenda të shkaktosh turbulenca dhe mjegullime, nuk është e drejte dhe aq më pak ta quajme bashkim... Të kërkosh fryt në një tokë jopjellore, është musibet prej musibeteve. Të habitesh me mundin e të huajve, ndërsa të nënvlerësosh mundin e të afërmëve tu, nuk është objektive.

Të mbivlerësosh sukseset e të huajve, ndërsa të nënvlerësosh sukseset e të afërmëve tu, kësaj i thonë shitje.

Të shikosh vetëm gabimet por jo edhe të arriturat, kësaj i thonë humbje të drejtpeshores.

Të krijosh armiq, nuk është vështirë, por të ballafaqohesh me ta nuk është lehtë.

“Kush ndihmon dhe përkrah të pavërtetën duke e ditur atë, vazhdon që të jenë nën Zemërimin e Allahut derisa ta braktisë atë. Dhe kush thotë për Muslimanin diçka që ai nuk e ka, do të banojë në “Radgatul-Khabaal” derisa t’i tërheqë mbrapa ato që ka thënë.”

Ta thërasësh armikun mik, ndërsa mikun armik, kësaj i thonë humbje të baraspeshës mendore, të akuzoni strategjinë dhe në emër të strategjisë së re të cilën e proklamoni ju, të synoni bashkim me ato armiq të cilët i keni krijuar vetë, me çdo kusht, duke heshtur për çështjet më madhore për të cilat duhet folur predikuesit e këtij Dini në çdo kohë dhe në çdo vend, jo vetëm kaq por duke ju bashkangjitur karvanit të armiqve tanë, (stacioni i fundit i të cilëve është dështimi) në akuzat dhe shpifjet e tyre kundra njerëzve për të cilët nuk nguroni të thoni se janë

arrogant, pa edep e kështu me radhe.

***“Kush ndihmon dhe përkrah të pavërtetën duke e ditur atë, vazhdon që të jenë nën Zemërimin e Allahut derisa ta braktisë atë. Dhe kush thotë për Muslimanin diçka që ai nuk e ka, do të banojë në “Radgatul-Khabaal” derisa t’i tërheqë mbrapa ato që ka thënë.”***

*Ne gjithmonë llogarisim të tjerët  
Ndërsa harojmë veten  
Tani vetmohu dhe llogarit vetveten  
A thua je i mirë te Allahu?*

Nëse gjykon do të gjykohesh, në vend që t'i thuash vëllaut tënd njeri pa edep, më mire është që të lutesh për të te Allahu që ta pastrojë nga ajo.

Të akuzosh strategjinë e ndokujt nga njëra anë dhe nga ana tjetër të shfaqen në opinion sekuenca nga jeta private të atij i cili akuzohet, të quhen ata të vegjël, nuk është e drejte dhe nuk është prej edepit, etikës si dhe prej kulturës Islame, të cilin aq shumë e potencojnë predikuesit e kësaj strategjie, kjo është jashtë kriteriueve të edukatës, kjo nuk mund të quhet ndryshe vetëm se delegim dhe degradim i nderit dhe autoritetit të këtyre personave në mënyrën më të paskrupullt.

E kemi obligim që muslimanëve t'ua sqarojmë të Vërtetën, Fenë e tyre, teuhidin, bazat e fesë.

**Me te vertete Allahu nuk fal qe te pershkruhet shok me te ne adhurim, por Ai fal pervec kesaj kujt te deshiroje.” [Nisaa 4:48]**

Disa njerëz mendojnë se sqarimi për çështjet më madhore nuk e ka kohën sot. Ata janë të gatshëm të flasin për çështjet dytësore, dhe të përçahen me vëllezërit të cilët flasin për çështjet parësore! Janë të gatshëm të kalojnë orë të tëra duke ligjeruar dhe sqaruar me endje një çështje nga fikhu, ndërsa nuk janë të gatshëm të flasin për çështjet parësore qoftë edhe për disa minuta... Kjo nuk është në pajtim me konceptin e strategjisë së sahabëve.. Sa për ta parë qëndrimin e tyre në këso raste po e cekim një rast kur Ibën Mes'ud tha në lidhje me namazin e halifës Uthman: "Namazi i Uthmanit nuk është korrekt." Ai nuk ka heshtur, siç mendojnë disa muslimanë se duhet heshtur para gabimit.

Të akuzosh strategjinë e ndokujt nga njëra anë dhe nga ana tjetër të shfaqen në opinion sekuenca nga jeta private të atij i cili akuzohet, të quhen ata të vegjël, nuk është e drejte dhe nuk është prej edepit, etikës si dhe prej kulturës Islame, të cilin aq shumë e potencojnë predikuesit e kësaj strategjie, kjo është jashtë kriteriueve të edukatës, kjo nuk mund të quhet ndryshe vetëm se delegim dhe degradim i nderit dhe autoritetit të këtyre personave në mënyrën më të paskrupullt...

Ka thënë Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem: **“Do vijne disa prijësa, do shihni prej tyre të mira e të këqija. Kush i kundërshton ata ka shpëtuar. Kush largohet prej tyre ka shpëtuar ndërsa kush përzihet me ta është shkatërruar”**

Të parët tanë nuk heshtën për çështjet dytësore, atëherë si të heshtim ne për çështjet parësore?!

Nevoja për ngritjen e zërit ndaj gabimeve është e padiskutueshme, dhe aq më shumë kur ata janë prej gabimeve serioze. E ku mbetet bashkimi me ata grupe?!!

**Kush shikon një të keqe ta ndryshojë atë me dorën e tij, nëse nuk mundet ta ndryshojë atë me gojën e tij dhe nëse nuk mundet ta ndryshojë atë me zemrën tij dhe ky është besimi më i dobët”.** (Hadithi sahih)

Një dijetarë thotë: “Refuzimi i kundërshtuesve të menhexhit të vërtetë, bën të dukshëm të kotën e tyre, poashtu bidatçive dhe ndihmuesve të tyre u bëhet e vështirë që të përhapin të

kotën e tyre. Në këtë mënyrë njerëzit largohen nga ata, urrejnë të kotën e tyre të cilën ua kanë zbukuruar disa prej njerëzve që i kanë ndjekur”.

Nëse bëjmë një analogji të ketyre fjalëve do të tingellonte si në vijim: “Bashkimi me kundërshtarët e menhexhit të vërtetë, vulos të kotën e tyre, poashtu bidatçive dhe ndihmuesve të tyre u bëhet e lehtë që të përhapin të kotën e tyre. Në këtë mënyrë njerëzit lakmojnë tek ata, e duan të kotën e tyre të cilën ua ka zbukuruar ky bashkim, dhe njerëzit të cilët i ndjekin.” Allahu na ruajtë nga kjo.

“Bashkimi me kundërshtarët e menhexhit të vërtetë, vulos të kotën e tyre, poashtu bidatçive dhe ndihmuesve të tyre u bëhet e lehtë që të përhapin të kotën e tyre. Në këtë mënyrë njerëzit lakmojnë tek ata, e duan të kotën e tyre të cilën ua ka zbukuruar ky bashkim, dhe njerëzit të cilët i ndjekin.”

Nëse ne e kemi dert davetin në përgjithësi, meëyren se si ajo prezantohet nga brenda dhe jashtë si dhe gjendjen e ndonjë predikuesi në veçanti që nuk përjashtohet nga bërja gabime, ngase askush nga ne nuk ka imunitet për këtë, atëherë e udhës do të ishte që të ulemi dhe së bashku të gjejmë mekanizma të pranueshme të cilat do të ofronin një artikulum apo zgjidhje të pranueshme dhe me këtë të afrohen zemrat dhe qëndrimet. Kjo strategji nuk është e re, kjo strategji daton prej më herët, edhe më herët ka qenë e kurorëzuar me deshtime, e që të njëjtat kanë filluar të përsëriten, kështu duke u ndarë xhemati në dyshe, kësaj i thonë ndryshe perçarje e cila nuk është synim i asnjë muslimani, janë krijuar armiqësi mes hoxhallarëve dhe xhematit, duke e humbur besimin e ndërsjellë dhe si rezultat krijohen paragjykime të shumta në mes tyre, ka bërë që autoriteti i ndokujt nga vet pasuesit e kësaj strategjie të shkrihet, janë shkaktuar hutit dhe turbulenca në kokat e xhematit të rëndomtë, duke e kthyer prapa për disa vite, kjo

strategji propaganduesit e më hershem të saj i ka bërë të heshtin dhe që e njehta përsëritet edhe sot, ngase prej thelbit të saj është që të heshtet për çështjet më madhore dhe për të cilat ngrihet pluhur nga pala tjetër, e cila me të madhe flet dhe i mbron qëndrimet e veta rreth të cilave ekziston kontesti mes neve, ka bërë që të tjerët të mendojnë se neve vrapojmë pas armiqeve tanë dhe jo ata pas neve, dhe nëse ja shtojmë edhe atë që të heshtet për çështjet kontestuese, atëherë i bie se ata janë në “hak”, ndërsa neve me heshtjen tonë ua bëjmë me dije se nuk posedojmë argumente, edhe pse realiteti është krejtësisht i kundërt, por kjo kështu vërehet në fushë (a jemi ne ata të cilët kemi dert manifestimin e davetit nga jashtë, a jemi ne strateg?!), dhe kjo është fundosje dhe jo progres, janë futur paragjykime të shumta në mendjet e xhematit më të dobishëm dhe më produktiv, dhe e gjithë kjo është bërë si çmim për të proklamuar këtë strategji të dështuar, dhe e gjithë kjo për të vazhduar për tu kurorëzuar me dëshpërim për disa herë radhazi.

Kjo në fjalë të shkurta, pak a shumë ishte një pasqyrë e gjendjes në të cilën gjendet daveti sot, mjerisht, duke shfaqur në skenë disa nga pasojat që ka shkaktuar më herët dhe vazhdon të shkakton në rrugën e davetit kjo strategji, ky iluzion, edhe pse jemi të vetëdijshëm që të gjithë mundohen për të mirën e Islamit dhe muslimaneve. Por njeriu mësohet prej gabimeve, dhe aq më shumë nuk duhet të përsëritet i njëjti gabim dy here e më shumë, ngase jemi më të mençur se kaq.

Allahu thotë: "Allahu u ka premtuar atyre që besojnë mes jush, dhe që veprojnë në bindje ndaj Allahut dhe të Derguarit të Tij, se Ai do t'u japë atyre pushtet në tokë ashtu siç u dha pushtet atyre përpara tyre, dhe se Ai do ta vendosë fene për ta, dhe do t'u japë pushtet që ta praktikojnë fene të cilën Ai e zgjodhi dhe urdheroi. Dhe Ai do ta nderrojë gjendjen e tyre në një gjendje sigurie, pas frikës së tyre. Ata më adhurojnë Mua dhe nuk më shoqerojnë asgjë. Dhe kushdo që e kundërshton këtë mirësi duke mos iu bindur Zotit, ata janë rrebele [fasikin]." [Nur 24:55]

"Dhe se kjo është rruga Ime e drejtë, prandaj pasojeni atë dhe mos pasoni rrugë të tjera që ju shmangin nga rruga e Tij".

Lusim Allahun që të na mundëson të vërtetën ta shohim si të vërtetë, ndërsa të kotën si të kotë. Allahu na bashkoftë në hak.

Përgatiti dhe përshtati: **Teuhid.NET**

[www.teuhid.net](http://www.teuhid.net)